



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
**Komuna e Glllogocit**  
Zyra e Kryetarit



Nr 01-90063-28773 dt. 20/06/2022

Bazuar në Ligjin Nr 03/L-164 për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit konkretisht nenin 3, paragraf 1, pika 1.1, nenin 4 të Udhëzimit Administrativ Nr. 23/2010 për Procedurat e Shpalljes së Programeve të Veçanta të Banimit, Programin Komunal Tre Vjeçar për Banim të Përkohshëm Social Nr. 01-400/01-21396 dt. 23/04/2019, si dhe Vendimin me Nr. protokoli 01-020/04-21288, të datës 16.05.2022 të Kryetarit të Komunës, Komisioni për çështjet e banimit të përkohshëm sociale shpall këtë:

**THIRRJE PUBLIKE PËR APLIKIM PËR SHFYTËZIMIN E  
PËRKOHËSHËM TË BANESAVE  
ME QIRA JOPROFITABILE NË BANIMIN E PËRKOHËSHËM SOCIAL  
TEK BLOKU I DHE II NË DRENASIN III**

Pasi që Kontratat mbi shfrytëzimin e përkohshëm të banesave me qira joprofitabile në objektet e Banimit të Përkohshëm Social, në Bllokun I dhe Bllokun II në Drenasin III, në Komunën e Drenasit janë në skadim, njoftojmë të gjithë banuesit e banimit të përkohshëm social se aplikimi fillon prej datës 20/06/2022 deri 20/07/2022.

**Gjithashtu në këto programe mund të aplikojnë edhe kategoritë e familjeve që :**

- Nuk kanë banesë/shtëpi në pronësi individuale
- Posedojnë sipërfaqe banimi nën normat e banimit të përcaktuara për kategoritë sociale dhe ekonomike.

**Kriteret për përcaktimin e radhës së përparësisë janë:**

1. Statusi i Banimit;
2. Lartësia e të ardhurave;
3. Gjendja shëndetësore;
4. Invaliditeti;
5. Struktura e familjës.

**Përparësi në përzgjedhjen e përfituesve kanë :**

1. Familjet me shumë fëmijë;
2. Familjet që në përbërjen e tyre kanë persona me aftësi të kufizuara;
3. Familjet ku kryefamiljari është grua-mbajtëse e familjes;
4. Bashkëshorti ose bashkëshortja e shkurorëzuar që ka në përkujdesje fëmijë;

5. Fëmijët me statusin e jetimit.

**Dokumentet e nevojshme për aplikim:**

- Fotokopja e letërnjoftimit për parashtruesin e kërkesës;
- Certifikatat e lindjes për anëtarët e familjës të parashtruesit të kërkesës;
- Certifikatat familjare;
- Vërtetim (informatë) mbi vendbanimin e përhershëm;
- Të dhënat për anëtarët e punësuar (nga punëdhënësi) dhe burimet e të hyrave të rregullta;
- Vërtetim nga MTI që personi kërkues dhe anëtarët e familjes nuk kryejnë aktivitet tregtar;
- Vërtetim nga Enti për punësim për të gjithë anëtarët e familjës të papunë;
- Vërtetim mbi shkollimin e rregullt;
- Të dhënat mbi gjendjen shëndetësore të parashtruesit të kërkesës apo të anëtarëve të familjës, të lëshuar nga ana e enteve shëndetësore të autorizuar ose të komisioneve profesionale;
- Vërtetim për dëshminë lidhur me statusin e familjës së dëshmorit;
- Vërtetim nga autoritetet përkatëse për dëshminë për përkujdesje ndaj fëmijëve jetim;
- Dokumente të tjera shtesë të nevojshme sipas rasteve.

Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve si dhe informacionet shtesë për dokumentacionet e nevojshme për aplikim mund t'i gjeni në sportelin e Komunës së Drenasit, Kati I (i parë), po ashtu përmes Web faqës së Komunës.

***Të gjithë personat që nuk aplikojnë brenda afatit të lartëshënuar, e humbin të drejtën për "Banim të Përkohshëm Social" në Komunën e Drenasit.***

Afati i paraqitjes së kërkesës fillon prej datës **20/06/2022 deri 20/07/2022**, ndërsa afati i shqyrtimit të kërkesës, si dhe lista e përfituesve do të shpallet në afatin e paraparë ligjor.

Kohëzgjatjen e përfitimit nga programet e veqanta të banimit, përkatësisht shfrytëzimi i banesave të Banimit të Përkohshëm Social me qira joprofitabile të caktuar me vendim të Kuvendit Komunal, sipas kësaj thirrje është në kohë të caktuar prej 2 vitesh, ndërsa numri i banesave që janë në dispozicion për programet e veqanta të banimit është 50 njësi banimi në Bllokun I dhe II të Banimit të Përkohshëm Social.

Komisioni për çështjen e banimit të përkohshëm social:

1. Lumturije Kiqina-Pisqaj
2. Albulena Lushtaku - Beletina
3. Vlorjan Meha
4. Shpejtim Nika
5. Besart Bajrami

